



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr.64, datë 13.09.2018**

**PËR**

**“PËRFUNDIMIN E PROCEDIMIT ADMINISTRATIV PËR ZGJIDHJEN E  
MOSMARRËVESHJES MIDIS ABCOM SH.P.K DHE GERANTINA ZYLO, PERSON  
FIZIK (FASTNET)”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 13.09.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP dhe Rregulloren nr. 18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1296, datë 11.06.2010 shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Përfundimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Abcom sh.p.k dhe Gerantina Zylo, person fizik (Fastnet)”.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Gërma n) e nenit 8, neni 120 të Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Pika 1 e nenit 41, pika 2 e nenit 79, neni 44, pika 1 e nenit 23, neni 16, neni 5, neni 82, neni 87, neni 14, neni 81, të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Neni 2, pika 6 e nenit 3, neni 9 i Rregullores së AKEP nr. 35, datë 10.07.2015 për “Përdorimin e Përbashkët të Faciliteteve dhe Aseteve të Rrjeteve të Komunikimeve

*Elektronike Publike*”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2583, Datë 10.07.2015, ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2615, Datë 10.09.2015;

4. Rregullore e AKEP nr.18, datë 11.06.2010 për “*Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve*”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1296, Datë 11.06.2010.
5. Pika p, e nenit 19 të Rregullores së “*Brendshme për Funksonimin e Këshillit Drejtues*”, miratuar me Vendim nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP.

## **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendim Nr.46, datë 29.06.2018 për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësit Abcom sh.p.k dhe Gerantina Zylo, Person Fizik (Fastnet)”;
- Vendimin Nr.55, datë 03.08.2018 për “Shtyrjen e afatit për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me VKD Nr.46, datë 29.06.2018 për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis ABCom sh.p.k dh Gerantina Zylo, person fizik (Fastnet)”, deri më datë 15.09.2018;
- Shkresë e Sipërmarrësit Abcom sh.p.k me shkresë nr. 194 Prot. datë 05.06.2018 (nr.1717 Prot. Datë 06.06.2018 i AKEP), bashkëlidhur Deklarata më datë 05.06.2018;
- Shkresë e sipërmarrësit Fastnet datë 09. 07 .2018, “Mbi vendimin N. 46 datë 29.06.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP”, (nr.1717/5 Prot, datë 19.07.2018 i AKEP), bashkëlidhur “Kontratë përdorimi për tubacionet nëntokësore” 29.12.2017, lidhur ndërmjet sipërmarrësit Fastnet dhe Bashkisë Korçë”;
- Shkresë e Bashkisë Korçë me Nr. 4893/1 Prot, datë 03.08.2018 (nr.1717 Prot. Datë 06.06.2018 i AKEP);
- Prova të administruara nga KZM dhe materiale të tjera të lidhura me çështjen;
- Projekt –Akti i formatuar dhe arsyetuar;
- Raport Përmbledhës mbi Projektvendimin.

si dhe nga konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje, fakteve të paraqitura e analizës së tyre referuar bazës ligjore të sipërcituar,

## **V Ë R E N:**

1. Sipërmarrësi Abcom sh.p.k me shkresë nr. 194 Prot. datë 05.06.2018 (nr.1717 Prot. Datë 06.06.2018 i AKEP), dhe shkresën “Parashtrime me shkrim të ankuesit shoqëria ABCom sh.p.k përpara KZM të AKEP”, datë 16.07.2018, ka dërguar pretendimet e tij duke argumentuar ndër të tjera si vijon:

Pretendimet e Abcom:

- a. ABCom ka ndërtuar infrastrukturë nëntokësore të rrjetit kabllor FO në qytetin e Korçës sipas Lejes së Ndërtimit nr. 1181 datë 19.05. 2016. Me

Çertifikatën e Përdorimit të lëshuar nga Bashkia Korçë nr. 2489/1 datë 07.12.2017, ABCom gëzon të drejtën e pronësisë dhe përdorimit e shfrytëzimit të kësaj infrastrukture dhe të rrjetit të shtrirë në të.

- b. ABCom ka shprehur gatishmërinë për përdorimin e pusetave të infrastrukturës së ndërtuar prej tij nga subjektet e treta, konkretisht subjekti Gerantina Zylo, person fizik (me emër tregtar FASTNET).
- c. ABCom ka insistuar vazhdimisht se lejimi i bashkëpërdorimit të pusetave, si pjesë e infrastrukturës nëntokësore në pronësi të ABCom, do të mund të realizohet nga subjekte të tjerë vetëm pasi të lidhet një marrëveshje për mënyrën e përdorimit të përbashkët të faciliteteve dhe aseteve sikurse janë pusetat, për të cilat ABCom gëzon pronësinë e tyre;
- d. Subjekti Gerantina Zylo, person fizik (me emër tregtar FASTNET), pavarësisht kërkesave të dërguara me shkrim nga ABCom, ankimeve dhe njoftimeve të përsëritura për ndalimin e menjëhershëm dhe të pa autorizuar të integritetit fizik të rrjetit të komunikimit elektronik të ndërtuar dhe në pronësi të ABCom, ka vijuar të ndërhyjë në këtë rrjet dhe në infrastrukturën përkatëse, duke mos reaguar ndaj kërkesës së ABCom për të lidhur Marrëveshje.
- e. Sipas ABCom përdorimi i paautorizuar i infrastrukturës së rrjetit përbën mundësi të theksuar për shkaktimin e dëmeve të konsiderueshme e me pasoja të rënda për ABCom.

2. Sipërmarrësi Fastnet, nëpërmjet shkresës “Mbi vendimin Nr. 46 datë 29.06.2018 të Këshillit Drejtues më datë 10.07.2018 (protokolluar në AKEP me nr. 1717/5, datë 10.07.2018), ka sjellë pretendimet e tij si më poshtë:

Pretendimet e Fastnet:

- a. Mbi pretendimet e subjektit ABCom sh.p.k për pronësinë e tubit apo të pusetave nuk na është vënë në dispozicion nga subjekti ankues asnjë dokument, i cili vërteton pronësinë mbi tubacionet të cilat janë paraqitur në ankesë. Nga i gjithë dokumentacioni që kemi në dispozicion kjo infrastrukturë rezulton të jetë pronë e Bashkisë Korçë. Abcom përdor tubacionin e shtrirë paralel me tubacionin e Bashkisë Korçë.
- b. Për përdorimin e infrastrukturës nëntokësore të Bashkisë Korçë, i jemi drejtuar asaj për të lidhur marrëveshje përdorimi për shfrytëzimin e infrastrukturës nëntokësore. Më datë 29.12.2017 Bashkia Korçë na mundëson marrëveshje kontraktuale mbi përdorimin e infrastrukturës së saj kundrejt detyrimeve financiare të cilat ne i shlyejmë dhe mund t'i vërtetojmë me dokumentacionin përkatës.
- c. Lidhur me pretendimet e ngritura nuk arrijmë të gjejmë një bazë ligjore për të bërë marrëveshje me një subjekt të caktuar (ent shtetëror, subjekt privat) pa disponuar më parë një titull pronësie apo administrimi të një prone të caktuar.

Vetëm në atë rast ne do të jemi të garantuar se marrëveshja që ne nënshkruajmë është fuqplotë, e vlefshme dhe e mbështetur në ligj.

- d. Nga ana jonë gjykojmë se mosmarrëveshjet për infrastrukturën nëntokësore i takojnë Bashkisë Korçë, e cila është investitori dhe pronar i infrastrukturës nëntokësore të cilën subjekti Geratina Zylo, ABCom. Tring, Abissnet apo operatorë të tjerë e përdorin nëpërmjet një kontrate përdorimi me bashkinë e Korçës.
  - e. ABCom është subjekt përdorues pranë Bashkisë Korçë njësoj si gjithë operatorët e tjerë. ABCom ka marrë leje gjatë punimeve në rrugë për shtrirjen e dy tubacioneve paralele duke përfutur si ekskluzivitet të drejtën e përdorimit (jo pronësinë mbi infrastrukturën nëntokësore), i vetëm të njërit prej tubave të shtruar, ndërsa tubi tjetër paralel do të përdoret nga operatorët e tjerë sipas kontratës së përdorimit me Bashkinë e Korçës.
3. Në referim me pikën 7.6 të Rregullores nr.18, datë 11.06.2010, KZM pas vlerësimit të të gjitha arsyetimeve, fakteve dhe argumentave të paraqitura nga palët, me shkresat Nr.1615/9 Prot., datë 11.07.2018 dhe Nr. 1615/8, datë 11.07.2018, ka ftuar respektivisht Sipërmarrësit ABCom sh.p.k dhe Geratina Zylo person fizik (FASTNET) në një takim për dhënien e sqarimeve të mëtejshme.

Takimi u zhvillua me datë 16.07.2018, ora 11.00 pranë ambienteve të AKEP. Gjatë takimit Sipërmarrësi ABCom sh.p.k dhe sipërmarrësi Geratina Zylo person fizik (FASTNET), konfirmuan edhe një njëherë qëndrimet dhe pretendimet e tyre. Pasi Komisioni bëri të gjitha përpjekjet për të zgjidhur mosmarrëveshjen me mirëkuptim, palët nuk ranë dakord për një zgjidhje të përbashkët. Komisioni u rikujtoi palëve edhe një herë afatin e fundit për dorëzimin e materialeve provuese deri më datë 17.07.2018.

KZM i është drejtuar gjithashtu Bashkisë Korçë me shkresë nr. 1717/8 Prot, datë 18.07.2018 për të zhvilluar një takim me të si palë e tretë e përfshirë në këtë mosmarrëveshje me qëllim dhënien e disa sqarimeve lidhur më situatën në fjalë. Bashkia Korçë nuk u paraqit në takimin e datës 23 Korrik 2018 ora 12.00.

KZM i është drejtuar përsëri Bashkisë Korçë me shkresën me nr. 1717/9 Prot, datë 26.07.2018 ku i kërkohet kësaj të fundit, informacion lidhur me marrëdhëniet juridike civile që ajo ka, me subjektet Abcom sh.pk. dhe Fastnet sh.p.k. Me shkresë nr. 4893/1 Prot, datë 03.08.2013 (nr.1717/11 Prot. Datë 08.08.2018 i AKEP), Bashkia Korçë i ka kthyer përgjigje kërkesës së AKEP për informacion duke vënë në dispozicion kontratën dhe dokumentet e tjera shoqëruese.

KZM ka vlerësuar se në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative konkretisht neni 91 pika 2: *“Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë”*, afati

për miratimin e një Vendimi përfundimtar nga Këshilli Drejtues duhet të jetë brenda 60 ditëve nga marrja e Vendimit të Këshillit Drejtues Nr.46, datë 29.06.2018 për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësit Abcom sh.p.k dhe Gerantina Zylo, person fizik (Fastnet)”.

Në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 44/2015, për shkak të kompleksitetit faktik të çështjes, nevojës për të disponuar gjithashtu një qëndrim zyrtar dhe nga Bashkia Korçë për këtë procedim administrativ, me qëllim shqyrtimin e plotë dhe gjithpërfshirës të pretendimeve dhe parashtrimeve të sipërmarrësit “ABCOM sh.p.k” dhe subjektit Gerantina Zylo, person fizik (FASTNET), në lidhje me kërkesën për zgjidhje të mosmarrëveshjes mbi përdorimin e përbashkët të infrastrukturës dhe faciliteteve për ofrimin e rrejteve/shërbimit të komunikimeve elektronike; me Vendimin Nr.55, datë 03.08.2018 për “Shtyrjen e afatit për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me VKD Nr.46, datë 29.06.2018 për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis ABCOM sh.p.k dh Gerantina Zylo, person fizik (Fastnet)”, KD ka vendosur shtyrjen e procesit deri më datë 15.09.2018.

4. Komisioni për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjes, në analizë të provave dhe rrethanave që paraqet çështja në fjalë, ka vlerësuar se AKEP ka kompetencë, për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, sa i përket përdorimit të facilitetit shoqëruar (puseta), në zbatim të fushës së veprimit dhe rolit që ka AKEP në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, bazuar në përcaktimet ligjore shprehur në nenin 5, pika 1 të Rregullores Nr. 18 datë 11.06.2010 për “*Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve*”, ku parashikohet shprehimisht se “*Fusha e veprimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është ajo e parashikuar nga ligji që do të thotë mosmarrëveshjet lidhur me përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe asetëve ndërmjet sipërmarrësve*”, si dhe pikës 6, të nenit 3 të Rregullores 35, datë 10.07.2015 për “*Përdorimin e Përbashkët të Faciliteteve dhe Aseteve të Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike Publike*”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.2583, e ndryshuar ku përcaktohet se: “*Në rast të dështimit të negociatave apo mos-marrëveshjeve të tjera të lidhura me përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, secila palë mund t’i drejtohet AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas procedurave dhe afateve të parashikuara në Ligjin 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kësaj rregulloreje dhe legjislacionit përkatës të aplikueshëm. Moszbatimi i këtyre Rregullave përbën shkelje të nenit 22 të Ligjit 9918/2008 i ndryshuar*”.

Nga ana tjetër, referuar përcaktimeve ligjore shprehur në nenin 5, pika 2, “*AKEP konsiderohet si një rregullator, i cili zbaton detyrat e veta në përmbushje të objektivave të veta ligjor*”, të Ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008 “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*” dhe Rregullores Nr. 18 datë 11.06.2010 për “*Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve*”, AKEP nuk ka tagër të vlerësojë mosmarrëveshjen, sa i përket të drejtave të pronësisë mbi infrastrukturën, konkretisht

(tubacionet), pasi elementë të tillë dalin jashtë fushës së veprimit dhe kompetencave të AKEP. Këto marrëdhënie juridiko civile në rast mosmarrëveshje janë objekt shqyrtimi i organeve gjyqësore.

5. Në referim të situatës faktike dhe përkufizimeve ligjore të Rregullores nr.35, datë 10.07.2015 për “Përdorimin e Përbashkët të Faciliteteve dhe Aseteve të Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike Publike”, operatori i infrastrukturës, sipërmarrësi ABCom sh.p.k, i cili zotëron efektivisht tubacionet dhe elementët e tjerë të rrjetit (pusetat) ku vendosen kabllot e operatorit përfitues, në këtë rast sipërmarrësi Gerantina Zylo, person fizik (Fastnet)”, subjekt i cili ka interes në përdorimin e faciliteteve dhe asetëve të infrastrukturës, duhet të disponojë një aktmarrëveshje për përdorimin e saj sipas nenit 9 të Rregullores nr. 35.

Në kushtet kur ka dy operatorë, rrjetet e të cilëve shtrihen në dy tubacione të ndara por pjesë e së njëjtës infrastrukturë, sipas kuptimit të ligjit 120/2016 për “Zhvillimin e Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë dhe Sigurimin e së Drejtës së Kalimit” (ligjit 120/2016); dhe aksesit kryhet vetëm nëpërmjet infrastrukturës pasive (pusetave) të rrjetit të sipërmarrësit “ABCom”, i cili është dhe investitori i infrastrukturës, aksesit në infrastrukturë i operatorit të dytë do të kryhet nëpërmjet një marrëveshje me investitorin e infrastrukturës ABCom, për të caktuar modalitetet e përdorimit të përbashkët të kësaj infrastrukture dhe për të shmangur dëmtimet e mundshme që mund të ndodhin gjatë kryerjes së punimeve nga njëra prej palëve. Kjo aktmarrëveshje duhet të përmbajë modalitete për, pjesën e infrastrukturës që do të përdoret në mënyrë të përbashkët, planin teknik, mënyrën se si do të aksesohen fasilitetet shoqëruese, përgjegjësitë në raste dëmtimesh të këtyre faciliteteve dhe afatet e vlefshmërisë së aktmarrëveshjes në përputhje me Rregulloren nr.35.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar Ligjin nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 114, neni 115 si dhe Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**) neni 33 e në vijim, pikë p e nenit 19 të Rregullores së “Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Drejtues”, miratuar me Vendim nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, Këshilli Drejtues

## **V E N D O S I:**

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me VKD Nr.46, datë 29.06.2018 për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis ABCom sh.p.k dh Gerantina Zylo, person fizik (Fastnet).

2. Moskompetencën e AKEP lidhur me shqyrtimin e mosmarrëveshjes midis ABCom sh.p.k. dhe Bashkisë Korçë, sa i përket pretendimit të ankuesit për disponimin e titullit të pronësisë mbi infrastrukturën nëntokësore të rrjetit kabllor FO në qytetin e Korçës.
3. T'u kërkojë palëve zbatimin e detyrimit për lidhjen e një marrëveshje për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të infrastrukturës referuar vecanërisht ligjit në fuqi dhe Rregullores nr. 35 datë 10.07.2015 “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike” e ndryshuar.
4. Të njoftohen palët e interesuara ABCom sh.p.k dhe Gerantina Zylo, person fizik (Fastnet).
5. Te njoftohet Bashkia Korçë për këtë Vendim.
6. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Ilir Zela**

**ANËTARË:**

1. **Alban KARAPICI**
2. **Edlira DVORANI**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**